KËRKESË
Nr.4689/4, datë 30.9.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rruga hyrëse Berat" (shtesat).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Sqarojmë që vlerësimi i pasurisë tokë, është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik"".

Pronari për të cilin është bërë shënimi "Rikonfirmim", do të kompensohet për efekt shpronësimi pasi të jetë bërë rikonfirmimi nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Pronarët për të cilët në kolonën "Shënime" në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP", do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është prej 864 900 (tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE TË CILËT PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS HYRËSE BERAT

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K	Nr.Pas.	Lloji i pas.	Sip. Shpron. (m^2)	Çmimi (lekë/ m^2)	Shuma (lekë)	Shuma totale (lekë)	Shënime
1	Nexhmedin	Sulejman	Malasi	8501	2/170	Truall	30	3100	93000	93000	Konf.ZVRPP
2	Nexhmedin	Sulejman	Malasi	8501	2/12	Truall	170	3100	527000	527000	Rikonfirmim
3	Çelnik	Hetem	Shuli	8501	2/172	Truall	79	3100	244900	244900	Konf.ZVRPP
	Shuma								864900	864900	